



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 46  
Prishtinë, 29 shtator 2009, në orën 11: 00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

**Morën pjesë:** Sadik Idriz, Teuta Hadri, Flora Brovina, Gjylnaze Sylja, Fatmire Berisha, Mimoza Ahmetaj, Qamile Morina dhe Nurishahe Hulaj.

**Munguan:** Sllobodan Petroviq, Rita Hajzeraj dhe Bujar Bukoshi.

**Të pranishëm:** nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit - Shpresa Haxhijaj, administratore, Fatime Qorri dhe nga Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës - Nexhat Shatri.

**Mbledhjen e kryesoi:** Sadik Idriz - kryetar i Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Rishqyrtimi i planit të punës të Komisionit për vitin 2009;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin nr. 02/1-36;**
- 5. Të ndryshme.**

*Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

*Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar me vërejtjet e deputetes Qamile Morina.*

## **3. Rishqyrtimi i planit të punës të Komisionit për vitin 2009**

**Sadik Idriz** – Tha se me plotësimin dhe ndryshimin e strategjisë legjislative të Qeverisë, që është proceduar në Kuvend, ka lindur nevoja ta bëjmë edhe plotësimin e planit të punës të Komisionit. Këto plotësime i kemi bërë. Hap diskutimin.

**Nurishahe Hulaj** – Sipas planit të punës të Komisionit kanë qenë shtatë ligje, të cilat është dashur të procedohen. Në bazë të strategjisë legjislative të Qeverisë, ne, si Komision, jemi në shpërputhje me planin e punës, sepse nuk kemi arritur t'i realizojmë objektivat e parapara. Lind pyetja, a do të arrijë Komisioni që për tre muaj t'i realizojë të gjitha sipas planit të punës për vitin 2009? Sidomos mbikëqyrja e ligjeve është çështja më kryesore.

**Sadik Idriz** –Tha se nuk ka ngecje të punës në Komision. Mosrealizimi i planit të punës është pasojë e mosprocedimit të ligjeve nga Qeveria. Komisioni ka bërë ankesë edhe në Kryesinë e Kuvendit lidhur me atë pse Qeveria nuk po i procedon ligjet e parapara për procedim për vitin 2009.

**Teuta Hadri** – Propozoi që Komisioni të marrë vendim që të mos e procedojë asnjë ligj tjetër pa u proceduar ligjet bazë. Komisioni në këtë vit duhet t i mbështesë vetëm Ligjin e punës dhe Ligjin për sigurime shëndetësore.

**Sadik Idriz** – Tha se ne ende nuk e kemi nisur procedurën e shqyrtimit të Ligjit për organizimin sindikal. Ne, si Komision, nuk mund ta tërheqim ligjin, por ne mund vetëm ta propozojmë tërheqjen e tij.

**Mimoza Ahmetaj** – Tha se duhet të diskutojmë për këtë strategji të punës dhe nuk e konsideroj në rregull nëse ne, si Komision, themi nuk duam ta procedojmë këtë ose atë ligj. Nuk shoh asnjë problem nëse Ligji për emblemën e Kryqit të Kuq procedohet edhe para Ligjit të punës ose para ndonjë ligji tjetër. Ne duhet të punojmë dhe të hapim rrugë për ligje të tjera. Është normale ta vazhdojmë kërkesën që ta kemi Ligjin e punës sa më parë që të jetë e mundur. Të gjithë e dimë, madje ministri disa herë e ka arsyetuar, pse nuk e kemi Ligjin e punës. Arsyeja kryesore janë mjetet financiare. Parimisht pajtohem me këtë plan të punës të ndryshuar në pajtim me strategjinë legjislative të Qeverisë.

**Gjylnaze Sylja** – Tha se plani i punës së Komisionit varet nga strategjia e Qeverisë. Nuk është në rregull të procedohen ligjet, që ligj bazë e kanë Ligjin e punës. Propozoi që planit të punës së Komisionit t'i shtohet edhe mbikëqyrja e ligjeve, si dhe dëgjimi publik për Ligjin për duhanin - nëse pajtohet Komisioni. Po ashtu kërkoi informatë për buxhetin e Komisionit, sepse nga kjo varen shumë aktivitete të tij. E përkrahu propozimin që Ligji për grevat dhe Ligji për organizim sindikal të mos procedohen para Ligjit për punë. Paraprakisht propozoi që Komisioni t'i ftojë të dy ministrat, në mënyrë që të marrim informata se ç' qëndrim kanë këto dy ministri për këto dy ligje bazë?

**Flora Brovina** – Tha se Ligji i punës mungon, jo vetëm në këtë mandat të kësaj Qeverie, por edhe në qeveritë e mëparshme. Grupi i punës, që e ka filluar mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për inspektoratin e punës. Ky është miratuar ndër ligjet e para në Kosovë, me premtimin se shumë shpejt do të procedohet Ligji për punën. Grupi është takuar me ministrin e MPMS- së dhe është informuar se Ligji i punës nuk është në Ministri, as në Qeveri, por në inspektim ndërkombëtar. Nëse ne, si Komision, deklarohemi se nuk do të procedojmë ligje të tjera, pa u proceduar Ligji i punës, kjo është një formë e presionit, që ai ligj të procedohet sa më parë.

**Qamile Morina** – Tha se në takimin që ka pasur Grupi për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për inspektoratin e punës me ministrin, kuptuam se Banka Botërore do të investojë 60 milionë euro në Kosovë. Lidhur me këtë e pyeti ministrin se për çka konkretisht janë destinuar këta 60 milionë. Përgjigjja ishte, 20 milionë në këtë vit do të merren për punësimin e qëndrueshëm, kurse në vitin e ardhshëm 40 milionë të tjera do të merren edhe për punësim, edhe për Ligjin. Banka Botërore ka premtuar në qershor që të angazhohet një ekspert të merret me ligjin. Mirëpo, ky premtim edhe pse ishte caktuar për qershor ose për maj, për pasojë Ministria i humbi tre muaj. Presioni ynë, si Komision, por edhe presioni i Ministrisë duhet të jetë më i madh duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me një ligj, me të cilin janë të ndërlidhura shumë ligje të tjera, e që do të mbesin të pavlefshme. Në strategjinë legjislativë të Qeverisë Ligji për sigurime shëndetësore nuk figuron fare.

Pas diskutimeve të deputetëve kryesuesi konstatoi: *Komisioni e miratoi planin e punës me ndryshimet e bëra në përputhje me strategjinë e ndryshuar legjislativë të Qeverisë. Ky plan mund të pësojë ndryshime për faktin se shumë gjëra nuk varen nga puna e Komisionit. Plani duhet të përfshijë edhe monitorimin e Ligjit për inspektoratin e punës dhe dëgjimin publik për Ligjin për duhanin.*

#### **4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin nr. 02/1-36**

**Sadik Idriz** – Komisioni ka formuar grup pune që do të merrej me shqyrtimin e këtij projektligji. Grupi i punës i ka propozuar Komisionit ta organizojë një dëgjim publik. Propozoi që Komisioni ta përkrahë propozimin e Grupit të punës.

**Flora Brovina** – Propozoi që Komisioni të marrë informata se çfarë ndryshimesh pësoi Ligji për duhanin në Kroaci, sepse Ligji për duhanin atje ka funksionuar, por ka qenë e pamundshme të zbatohet dhe me plotësime e ndryshime janë bërë disa lëshime. Duke pasur parasysh situatën në Kosovë, gjendjen e pasluftës, gjendjen ekonomike jo të mirë, duhani pihet me të madhe dhe një kufizim kaq i ashpër, siç është paraparë me këtë projektligj do të ishte e pamundur të zbatohet.

**Nurishahe Hulaj** – Grup i punës ka mbajtur takim, në të cilin e shqyrtoi Projektligjin për duhanin dhe propozoi të mbahet një dëgjim publik. Projektligji e ka kaluar leximin e parë. Ky ligj ishte paraparë të hynte në fuqi më 1 janar 2005, pastaj më 1 janar 2007. Rregullorja e UNMIK-ut 1/2007 e ka ndaluar hyrjen në fuqi të këtij ligji, sepse është dashur të bëheshin edhe disa ndryshime. Pas kësaj Qeveria e mëparshme e formoi Këshillin Profesional, që punoi shumë. Pse ishin të nevojshëm ndryshimi dhe plotësimi i këtij ligji: a) laboratorit, b) ISO- standardet dhe c) ballina etj.

**Mimoza Ahmetaj** – Pyeti çka është “*Letra e Përkushtimit*” dhe a kemi ne kuadër profesional për laborator?

**Nurishahe Hulaj** – Letra e përkushtimit për zbatimin e Ligjit për duhanin është hartuar sipas hulumtimeve shkencore. Në bazë të kësaj Këshilli Profesional kërkoi nga kryeministria ta nënshkruante këtë letër. Pra, “*Letra e bardhë*” është një hulumtim. Për laborator kemi kuadër, por parashihet edhe kuadër shtesë.

**Teuta Hadri** – Ne nuk i dimë saktësisht se cilat ndryshime janë paraparë. Është paraparë laborator, por nuk është paraparë vlera e tij.

**Gjynaze Syla** – Falënderoi deputeten Nurishahe Hulaj për përkushtimin që ka për këtë ligj. Ky projektligj ka paraparë dy ndryshime thelbësore që i përmendi deputetja Nurishahe Hulaj. Në thelb Komisioni, a duhet t’i përkrahë këto ndryshime apo jo? Për këtë do të na ndihmojë dëgjimi publik – në të cilin do të jenë të ftuar edhe përfaqësues nga ministrinë dhe nëse marrim informatë se të hollat për laborator nuk do të ndahen, atëherë Komision vjen në përfundim se nuk mund të bëjmë laborator. Po ashtu ky dëgjim ka për qëllim sensibilizimin për pasojat e pirjes së duhanit dhe efektet në shëndet dhe buxhet.

Pas diskutimeve të deputetëve kryesuesi konstatoi: *Komisioni e miratoi propozimin e grupit të punës për mbajtjen e dëgjimit publik për Ligjin për duhanin. Datën e mbajtjes së dëgjimit publik e cakton kryetari i Komisionit me grupin e punës.*

## 5. Të ndryshme

**Sadik Idriz** – I njoftoi anëtarët e Komisionit për kërkesën që ia kishte drejtuar Kryesia, sipas së cilës komisionet parlamentare janë të detyruara t’i raportojnë Komisionit për Integrime Evropiane për kryerjen e detyrimeve që dalin nga PVPE-ja.

I njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me informatat e stafit të AKPM-së, si dhe për përgjigjen e Ministrisë. Propozoi që këtë material ta shqyrtojnë anëtarët e Komisionit dhe në mbledhjen e radhës të diskutohet për të.

**Mimoza Ahmetaj** – Lidhur me kërkesën e punëtorëve të AKPMS-së pyeti pse një kërkesë e tillë është vonuar aq shumë, përderisa ky problem është trajtuar në mediat që nga data 16 shtator. Për të debatuar lidhur me këtë është dashur ta kishim marrë materialin më parë, që t’i analizojë kërkesat e punëtorëve dhe argumentet e MSH-së.

**Qamile Morina** – Propozoi që Komisioni të deklarohet nëse do ta përkrahë atë për përgjigjen me shkrim, që ajo e ka përgatitur për MSH-në, lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit për veprimtari private në shëndetësi.

Ajo tha se Komisioni disa herë ka diskutuar për nevojën e tij që të shkojë jashtë vendit për përvojë lidhur me Ligjin për punën dhe për sigurimet shëndetësore. Pyeti, a ka bërë kryetari i Komisionit kërkesë dhe përgjigje zyrtare, sepse ky udhëtim nuk po realizohet. Nëse nuk është bërë kërkesa, propozoi që në emër të Komisionit ajo të bëhet dhe Komisioni të marrë përgjigje lidhur me të.

**Teuta Hadri** – Tha se buxheti prej 10 mijë euro, i ndarë për Komision nuk ka humbur, por jemi të detyruar ta shfrytëzojmë deri në fund të këtij viti.

**Sadik Idriz** – Lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për veprimtari private në shëndetësi, tha se Kuvendi e ka miratuar raportin me rekomandime të proceduar nga Komisioni. Hapi diskutimin lidhur me propozimin e deputetes Qamile Morina.

**Qamile Morina** – Tha se kjo shkresë është vetëm një përgjigje për ministrin, sepse ministri në përgjigjen e tij lidhur me raportin dhe me të gjeturat e Komisionit është mbështetur në dispozita që nuk ekzistojnë fare.

**Gjylnaze Sylja** – Mbështeti deputeten Qamile Morina vetëm me propozimet që ajo i ka bërë dhe propozoi që në fund të kësaj shkrese ministrit duhet t'i rikujtohet detyrimi për përmbushjen e rekomandimeve të dala nga Kuvendi. Komisioni mund ta ftojë ministrin dhe të shohim se cilat rekomandime i ka përmbushur dhe cilat jo.

**Sadik Idriz** – Tha se Komisioni do të ftojë ministrin në një nga mbledhjet e tij dhe do të debatohet pikërisht për çështjet të cilat i ka identifikuar deputetja Qamile Morina. Sa i përket vizitës diku jashtë ne si Komision duhet të përcaktojmë qëllimin për të dalë jashtë vendit. Ligjet për të cilat ju propozoni ende nuk janë proceduar në Kuvend.

**Flora Brovina** – Tha se Komisioni mund ta caktojë një pikë të rendit të ditës për përgjigjen që ministri e ka dhënë lidhur me raportin e Komisionit. Komisioni mund ta autorizojë deputeten Qamile Morina që në mbledhje, të ftohet ministri i Shëndetësisë që në emër të Komisionit të flasë për këtë çështje. Në njërin nga mbledhjet e radhës, duhet t'i kemi të dy kopjet e raporteve: të raportit të ministrit, si dhe shkresën e deputetes Qamile Morina dhe t'i shqyrtojmë ato.

**Nurishahe Hulaj** – Tha se arsyeshmëria që Komisioni ta vizitojë ndonjë shtet për të shkëmbyer përvojë ekziston, sepse kemi raportin e progresit. Komisioni duhet t'i shqyrtojë raportet e punës. Këtë po e bëjmë. Komisioni duhet të iniciojë nëpërmjet Qeverisë miratimin e ligjeve përkatëse. Si t'i tejkalojmë këto situata?

Pas diskutimeve të deputetëve kryesuesi konstatoi: *Do të shqyrtohet mundësia që Komisioni ta bëjë një vizitë pune në Slloveni.*

**Flora Brovina** – I njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me punën e Grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për inspektoratin e punës. Grupi i punës e hartoi planin e punës dhe i realizoi dy vizita. Një në MPMS dhe një në Inspektoratin e punës. Grupi i punës do të vazhdojë me vizita në terren dhe ndoshta do të ishte mirë që njërin nga institucionet ta vizitojnë tërë anëtarët e Komisionit.

**Gjylnaze Sylja** – I njoftoi anëtarët e Komisionit se heq dorë nga Grupi i punës për monitorimin e Ligjit për inspektoratin e punës, sepse është e angazhuar edhe në shqyrtimin e Projektligjit për duhanin.

Mbledhja përfundoi në orën 12 : 30

E hartoi  
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

---

Sadik Idriz